



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1879/7 prot.

Tiranë më 29.12.2022

VENDIM

Nr. 70, datë 29.12.2022

PËR KONTROLLUESIN “BCONNECT SHPK”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “BConnect SHPK”, (në vijim, “Kontrolluesi”).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 186, datë 31.10.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi ushtron veprimtarinë në fushën e “Call Center” për llogari të shoqërisë italiane Covisian S.p.A. Kjo veprimtari konsiston në ofrimin e shërbimit “call center” për të drejtuar në mënyrë eficiente telefonata hyrëse (Inbound), ku realizohen aktivitete me qëllim shitje, marrje porosie, asistencë klientësh, etj., për shtetasit

italian. Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “punonjës”, “vizitorë”, “kandidatë për punë”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Konstatohet se, Kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit përdor sisteme elektronike online të ofruara nga shoqëria Covisian S.p.A, si: “Sparta web/al”, “Timekeeping”, “Sparta al”, “Salesforce”, “Pega”, “Remedy”, “NetDB”, “CCpluse”, “Kataweb” dhe “Nipo”. Këto sisteme administrohen nga shoqëria Covisian S.p.A me vendndodhje në shtetin italian, të cilët shërbejnë për operatorët, klientët italian dhe burimet njerëzore. Kontrolluesit i është dhënë qasje në sistemet “Sparta web/al”, “Timekeeping”, “Sparta al”, nga Covisian S.p.A, me attribute si klient.

Sistemi elektronik “Sparta web/al” mundëson menaxhimin e agjendës së punës për të gjithë operatorët punonjës të Kontrolluesit. Të dhënat personale të operatorëve që përpunohen në këtë sistem janë: “emër”, “mbiemër”, “numër telefoni”, “adresa personale email”, “data e lindjes”, etj. Ndërsa sistemi elektronik “Timekeeping”, është sistemi në të cilin deklarohen të dhënat financiare të nëpunësve të Kontrolluesit, dhe përmbajnë të dhëna personale si “emër”, “mbiemër”, “paga”, etj.

Nga verifikimi në vend, të sistemit “Sparta web/al”, rezulton se ndër të tjera, ruhen të dhëna personale për personat të cilët janë të larguar nga puna. Gjithashtu, të dhënat e ish-punëmarrësve ruhen pa afat edhe në arkivën fizike të Kontrolluesit. Përmbajtja e dosjeve personale të ish-punëmarrësve, konsiston në dokumente origjinale, të noterizuara dhe/ose të fotokopjuara, jetëshkrime, kopje të kartës së identitetit/pasaportës, vërtetim të gjendjes gjyqësore, etj.

Konstatohet se Kontrolluesi nuk ka parashikuar asnjë afat konkret për mbajtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 11 datë 08.09.2011 “Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i afateve kohore konkrete në lidhje me ruajtjen e të dhënave, duhet të jetë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, qëllimin e përpunimit, dhe në mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky konstatim vjen në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave sanksionuara në germat “b” dhe “d” të pikës 1, të nenit 5 dhe kriteret ligjore të përpunimit të parashikuar në nenin 6 të Ligjit.

3. Konstatohet se Kontrolluesi për qëllime rekrutimi, publikon njoftime punësimi në faqe të tilla si www.duapune.com, www.njoftime.com, etj. Gjithashtu, kandidatët e

interesuar mund të kontaktojnë “BConnect SHPK” nëpërmjet llogarisë së krijuar në faqen www.duapune.com ose në mënyrë të drejtpërdrejtë në adresën e postës elektronike (e-mail), si dhe mund të paraqesin dokumentacionin e aplikimit fizikisht në ambientet e Kontrolluesit.

Sa më sipër, Kontrolluesi për qëllim të rekrutimit, mbledh jetëshkrimet (CV), ID, etj., të “kandidatëve për punë”. Rezulton gjithashtu se, Kontrolluesi aplikon me kandidatët për punë, një formular në gjuhën italiane “Procedura HR Recruiter”, ku përmes këtij formulari mbledh të dhëna personale të tilla si: “emër”, “mbiemër”, “data lindjes”, “adresa”, “telefoni”, “adresë e-mail”, etj.

Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka mundur të dokumentojë se gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave të “kandidatëve për punë”, (përmes njoftimeve në faqe të ndryshme të punësimit po ashtu edhe çfarë do lloj tjetër formë komunikimi si posta elektronike, etj.) realizon informimin e subjekteve të të dhënave për fushën dhe qëllimin e përpunimit, si dhe në lidhje me të drejtat e tyre, mënyrën e përpunimit të të dhënave, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim dhe/ose fshirje të të dhënave, të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 42 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë”, (në vijim, “Udhëzimi nr. 42”).

Gjithashtu, sa i përket politikës së privatësisë (*bashkëlidhur procedurës HR recruiter*) të administruar gjatë hetimit administrativ pranë zyrës së burimeve njerëzore të Kontrolluesit, rezulton se kjo politikë ka për objekt: “informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë, që janë marrë për të dhënat që deklarohen në faqen web...” por nga analiza e këtij dokumenti rezulton se ai nuk pasqyron/dokumenton realisht informimin e “kandidatëve për punë”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Konstatohet se nga punonjësi i receptionit, mblidhen të dhëna personale të individëve që vizitojnë ambientet e Kontrolluesit, të cilat ruhen në një regjistër elektronik, në një adresë private në domain “Google”. Të dhënat përmbajnë, ndër të tjera, “emër”, “mbiemër”, “data”, “tip i dokumentit”, “numër identifikimi (ID) i vizitorit”, etj.

Konstatohet se, “Numri personal identifikimi i vizitorit (NID)” grumbullohet dhe ruhet në regjistrin elektronik të vizitorëve, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së

të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, kategoritë e të dhënave të mbledhura, në regjistrin e të dhënave të individëve/vizitorëve që aksesojnë ambientet e “BConnect SHPK”, duhet të jenë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, qëllimin e përpunimit, dhe në mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Ruajtja e të dhënave të vizitorëve, në një regjistër elektronik, në një adresë private në domain “Google”, përbën një risk të shtuar sa i përket garantimit të sigurisë së të dhënave të ruajtura në këtë email, i cili rezulton të jetë jashtë infrastrukturës TIK të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se konstatimi vjen në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave sanksionuara në gerrat “b” dhe “d” të pikës 1, të nenit 5, kriteret ligjore të përpunimit të parashikuar në nenin 6 si dhe masat për sigurinë e të dhënave personale të parashikuar në nenin 27 të Ligjit.

5. Kontrolluesi disponon një sistem video survejimi (CCTV), i përbërë nga 13 kamera të cilat survejojnë korridoret, ambientet e brendshme të zyrave call center dhe receptionin. Konstatohet se kamerat janë pozicionuar në ambientet e brendshme të zyrave, në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.11 të Komisionerit.

Gjithashtu, konstatohet se kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e punës ku fokusohen punonjësit, cenon privatësinë e tyre dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë, referuar gerrmës “c”, të nenit 5 të Ligjit, kriteret ligjore të përpunimit, dhe Udhëzimin nr.11 të Komisionerit, në përmbajtje të të cilit parashikohet se përdorimi i një sistemi vëzhgimi të vazhdueshëm në ambientet e punës përdoret vetëm për qëllim të sigurisë personale të punonjësve dhe të personave të tjerë në këto ambiente, për mbrojtjen e pronës dhe për parandalimin ose hetimin e situatave që rrezikojnë sigurinë, por jo për mbikëqyrjen e punonjësve në vendin e punës.

Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ një kontratë “tip” në gjuhën italiane dhe një kopje të noterizuar midis palëve Covisian S.p.A me NIPT 07466520017 dhe “BConnect Sh.p.k” me NUIS: L31720003A.

Gjithashtu rezulton se Kontrolluesi në datë 01.09.2022 ka lidhur një kontratë shërbimi me personin fizik Edlira Doksani me NUIS: M0172713R me objekt *“Ofrimin e shërbimeve mjekësore ndaj porositësit sipas kushteve dhe kritereve të kësaj kontrate dhe Kodit Civil Shqiptar”*.

Nga shqyrtimi i kontratës me palën Covisian S.p.A, fillimisht rezulton se në të nuk janë parashikuar detyrimet midis palëve, sipas legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërsa sa i përket parashikimeve të nenit 4 *“Privacy”* të kësaj kontrate, rezulton se detyrimet e përcaktuara janë të karakterit të përgjithshëm, si dhe nuk i përmbahen parashikimeve të nenit 20 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit, vlerëson se, në të dyja kontratat e vendosura në dispozicion nga Kontrolluesi, nuk janë përfshirë detyrimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit në një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”* i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë tip, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave tek përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunim të ligjshëm të të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të ligjit dhe rregullohen me aplikimin e parashikimeve të Udhëzimit nr. 19.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka *“Njoftuar”* mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, megjithatë është konstatuar se *“Njoftimi”* ka mangësi në deklaram sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- Deklarimin në rubrikën 1.1, të formularit të njoftimit *“Të dhënat e subjektit kontrollues”*;
- Deklarimi në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit *“Kategoritë e subjekteve të dhënave personale që përpunohen”*, të tilla si: *“vizitorë”*;

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Sipas përcaktimeve të Ligjit, Njoftimi duhet të bëhet para se Kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë, sipas nenit 22 të këtij Ligji.

7. Kontrolluesi nuk disponon rregullore “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të shoqërisë.

Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”), për shkak cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson gjithashtu se, për shkak të cilësisë si subjekt i madh përpunues, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore dhe paraqiti pretendimet me shkrim lidhur me shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit.

1. Lidhur me konstatimin e pikës së dytë të procesverbalit, Kontrolluesi pretendon se nuk është në kushtet e shkeljes së dispozitave të sipërcituara pasi, në të gjitha Kontratat Individuale të Punës (neni 3), ka të parashikuar një afat minimal brenda të cilit shoqëria ruan të dhënat e punëmarrësve. Ndërkohë që, përveç detyrimeve që lindin nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, subjekti ka edhe detyrime të

cilat lindin nga Ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë, sikur është edhe Kodi i Punës. Në një subjekt tregtar ku janë të punësuar mbi 300 punëmarrës, në përfundim të marrëdhënies së punës secili prej tyre mund të ngrejë pretendime kundrejt Punëdhënësit, dhe ky i fundit është i detyruar të ruajë dosjen e secilit punëmarrës për aq kohë sa Kodi i Punës parashikon afatin tre vjeçar të parashkrimit të të drejtave të të dyja palëve kundrejt njëra-tjetrës. Ndërsa, lidhur me arkivin fizik, dhe gjetjen e konstatuar, të dosjes së një punëmarrësi i cili është larguar nga puna në fund të vitit 2018, sqarojmë se, shoqëria është mjaft e kujdesshme në ruajtjen e të dhënave personale dhe ekziston një politike e shoqërisë për fshirjen e këtyre të dhënave brenda një afati 36 muajor të parashikuar edhe në kontratat e punës dhe në dokumentet e privatësisë të nënshkruara nga secili punëmarrës. Dosja e konstatuar nga inspektorët, ka të bëjë me një pakujdesi e cila lidhet me fluksin e madh të punëmarrësve dhe personave të cilat menaxhohen në përditshmëri nga ana e Shoqërisë "BConnect". Kontratat e punës të punëmarrësve dhe deklaratat e nënshkruara prej tyre përmbajnë aktualisht afatet e ruajtjeve të këtyre të dhënave deri në 36 muaj dhe jo pa afat sikurse pretendohet. Për të gjitha këto arsye, ky konstatim nuk mund të konsiderohet në shkellje të dispozitave ligjore të cituara nga grupi i inspektimit, për sa kohë nuk citohet kush nen, paragraf apo shkronjë e neneve të cituara është shkelur nga ana e shoqërisë dhe për më tepër kur vetë ligji e lë në dorë të subjektit vendosjen e afatit.

Lidhur me këtë pretendim të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron pasi, përcaktimi i afateve kohore duhet të jetë i parashikuar konkretisht në akte të brendshme rregullatorë/politika etj. Sikurse është parashikuar në gërmën "d" të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit e cila përcakton se: "Mbrotjtja e të dhënave personale bazohet në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.", Kontrolluesi duhet të identifikoj rast pas rasti kategoritë e të dhënave që përpunon dhe duhet të përcaktojë afatet e ruajtjes së këtyre të dhënave në aktet e veta të brendshme rregullatore, në përputhje me qëllimin e grumbullimit/apo afate të tjera të përcaktuara në një dispozitë ligjore konkrete.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin se në kontratat individuale të punës, është përcaktuar një dispozitë ku parashikohet afati për ruajtjen e dokumentacionit të punonjësit të larguar, vlerësojmë se pavarësisht parashikimit të kësaj dispozite, në kontratat me punonjësit, efektivisht nga Kontrolluesi nuk janë marrë masa konkrete për zbatimin e saj, pasi nga shqyrtimi i arkivës fizike, janë marrë në cilësinë e provës materiale dosje të punëmarrësve të larguar në vitin 2018.

2. *Lidhur me konstatimin e pikës së tretë të procesverbalit, kontrolluesi pretendon se në dokumentet të cilat janë bërë pjesë e dosjes së inspektimit ka rezultuar një formular i cili i përket disa viteve më parë (objekt i përditësimeve të vazhdueshme dhe që është vendosur në dispozicion edhe versioni që aktualisht përdoret) dhe në secilin prej tyre përshkruhet qartësisht politika e privatësisë dhe të gjitha informacionet lidhur me përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me Udhëzimin në fjalë. Aktualisht*

formulari është i përditësuar, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar informimi kundrejt subjektit të të dhënave. Prandaj, edhe ky konstatim mbetet i pabazuar në prova dhe në ligj dhe Shoqëria kërkon të administrohet dhe citohet në vendimin përfundimtar çdo dokument që Shoqëria i ka vënë në dispozicion grupit të Inspeksionit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë pasi informimi i qartë, u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Konkretisht, Kontrolluesi nuk ka mundur të dokumentojë se në rastin e njoftimeve që kryen në faqe të ndryshme të punësimit (*po ashtu edhe çfarë do lloj tjetër forme komunikimi si posta elektronike, etj.*) se realizon informimin e subjekteve të të dhënave, për fushën dhe qëllimin e përpunimit, si dhe në lidhje me të drejtat e tyre, mënyrën e përpunimit të të dhënave, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim dhe/ose fshirje të të dhënave, të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 42 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë*”, (ne vijim, “*Udhëzimi nr. 42*”).

- Lidhur me konstatimin e pikës së katërt të procesverbalit Kontrolluesi pretendon se, sa i përket, arsyetimit të kryer nga ana e Inspektorëve, jemi të mendimit se është i pabazuar për arsye se, personat e jashtëm të cilët hyjnë në ambientet e shoqërisë, subjekt privat, duhet të jenë të identifikueshëm dhe të identifikuar. Përveç këtij fakti, kemi vënë në dispozicion të Inspektorëve dokumentin e privatësisë, në të cilin vizitori informohet dhe jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale, ku përcaktohet edhe se cilat janë këto të dhëna që regjistrohen dhe qëllimi i tyre. Për më tepër, aksesin në këtë regjistër e ka vetëm një person i autorizuar nga ana e shoqërisë. Në procesverbalin e Hetimit Administrativ, nuk është përcaktuar cila pikë e neneve përkatëse rezulton të jetë shkelur nga subjekti i hetimit, pasi sipas provave rezulton të mos jetë shkelur asnjë pikë e nenit 5 ku në përmbajtje të tij, përcaktohet përpunimi i drejtë dhe i ligjshëm i të dhënave; grumbullimi për qëllime specifike; mjaftueshmëria e tyre; saktësia e të dhënave dhe mbajtja e tyre për një kohë jo më tepër sesa është e nevojshme. Asnjë nga këto pika nuk rezulton të jetë shkelur nga ana e "BConnect". Ndërsa, për sa i përket nenit 6 të po këtij ligji, ku përcaktohen kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, një nga këto kriteret është kur subjekti të dhënave jep pëlqimin e tij, sikurse rezulton të jetë edhe konkretisht sipas dokumentit të vënë në dispozicion për rastin në fjalë. Të gjitha këto arsye, bëjnë të mundur që argumentimet e Inspektorëve të jenë të pabazuara në prova konkrete dhe në ligj;*

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e kontrolluesit nuk qëndrojnë pasi “*Numri personal identifikimi i vizitorit (NID)*” grumbullohet dhe ruhet në regjistrin

elektronik të vizitorëve, në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

Kategoritë e të dhënave të mbledhura, në regjistrin e të dhënave të individëve/vizitorëve që aksesojnë ambientet e “BConnect SHPK”, duhet të jenë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave në lidhje me qëllimin e përpunimit, në këtë kuadër mbajtja e numrit personal për identifikimin e vizitorit nuk i shërben qëllimit të Kontrolluesit për të garantuar sigurinë.

Gjithashtu, ruajtja e të dhënave të vizitorëve, në një regjistër elektronik, në një adresë private (të një punonjësi) në domain “Google”, përbën një risk të shtuar sa i përket garantimit të sigurisë së të dhënave të ruajtura në këtë email, i cili rezulton të jetë jashtë infrastrukturës TIK të Kontrolluesit.

- Lidhur me konstatimin e pikës së pestë të procesverbalit Kontrolluesi pretendon se, sa i përket kamerave dhe pozicionimit të tyre, sikurse rezulton dhe nga provat e vëna në dispozicion të inspektorëve, ato janë të vendosura nga lart, pra mbikqyrin nga sipër ambientet e shoqërisë, korridoret dhe hyrjen, si dhe nuk janë të vendosura në ambiente personale të punëmarrësve apo zona ndërrimi etj. Qëllimi i vendosjes së këtyre kamerave lidhet ngushtësisht me sigurinë e shoqërisë nga ndërhyrjet nga të tretë por edhe për sigurinë personale të vetë punëmarrësve duke marrë parasysh edhe faktin që më herët ka pasur raste konkrete që midis punëmarrësve të ketë pasur mosmarrëveshje të cilat kanë nevojë të sqarohen nga stafi drejtues i Shoqërisë, dhe kjo është një mbrojtje më shumë për to. Ndërsa, lidhur ekzistencën e rregullave, nga inspektimi ka rezultuar se shoqëria është treguar transparente dhe në respektim të Udhëzimit nr. 3 ka vendosur tabelat informuese në hyrje dhe përpara se personat të futen në ambientet ku janë të vendosura kamerat. Në këto tabela është përcaktuar qartë se “Subjekti i të dhënave personale, mund ti ushtrojë të drejtat e tij sipas Ligjit nr. 9887 datë. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Rezulton e provuar se shoqëria ka informuar paraprakisht për ekzistencën e kamerave në ambiente. Ashtu sikurse ka rezultuar edhe gjatë fazës së inspektimit, Inspektorët kanë marrë të gjithë informacionin e duhur lidhur edhe me personin e autorizuar (IT) për të pasur aksesin në këto të dhëna dhe dhomën ku mbahet serveri. Ky i fundit mbahet në një dhomë të veçantë dhe i mbyllur me çelës.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e kontrolluesit nuk qëndrojnë pasi instalimi i sistemit të kamerave dhe survejimi në ambientin e punës, mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem, nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër. Përpunimi i të dhënave personale duhet të bazohet gjithashtu në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim. Përpunimi i të dhënave personale me anë të sistemit të video-surveimit (CCTV) pa pëlqimin e subjektit të të dhënave është i ligjshëm, por gjithnjë duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Sa i takon pretendimit të Kontrolluesit se dokumenti “*Informativa sul trattamento dei dati personali*”, është një dokument informues mbi përpunimin e të dhënave personale dhe subjekti i të dhënave jep pëlqimin e tij, fillimisht rezulton se ky dokument, sikurse shumë të tjerë të Kontrolluesit, referon legjislacionin italian për mbrojtjen e të dhënave personale, duke i pamundësuar informimin mbi të drejtat subjektit të të dhënave sipas legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Lidhur me pretendimin e Kontrolluesit se ka garantuar pëlqimin nga subjektet e të dhënave (*punëmarrës*) Zyra e Komisionerit vlerëson se, “*Pëlqimi*”, është një nga 6 principet ligjore për përpunimin e të dhënave personale, parashikuar në pikën 1 të nenit 6 të ligjit. Në rastin ku kontrolluesi fillon një përpunim të dhënash, ai duhet të konsiderojë se cila është baza e përshtatshme ligjore për vazhdimin e përpunimit. Në përgjithësi, “*pëlqimi*” mund të jetë një bazë ligjore e përshtatshme, nëse subjektit të të dhënave i është ofruar kontroll, si dhe i është ofruar mundësi e qartë për të pranuar apo refuzuar termat e ofruara, ose ti refuzojë i pakushtëzuar. Kur kërkon “*pëlqimin*”, kontrolluesi duhet të vlerësojë nëse ai plotëson të gjitha kërkesat për të garantuar një “*pëlqim*” të vlefshëm.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrolluesi duhet të hartojë një rregullore specifike në të cilën të parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave të përpunuara nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV).

5. *Lidhur me konstatimin e pikës së gjashtë të procesverbalit Kontrolluesi pretendon se në interpretim të dispozitave ku inspektorët kanë bazuar gjetjet e tyre, në lidhje me marrëveshjen që lidhet midis kontrolluesit dhe përpunuesit bëjmë me dije se për aq kohë sa në kontratat në fuqi dhe të vëna në dispozicion rezultojnë të parashikuara kërkesat ligjore të nenit 20 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 19, konkretisht, lidhur me kontratën midis BConnect dhe Covisian, në nenin 4 të tij janë parashikuar detyrimet për përpunim dhe kushtet e nevojshme teknike organizative dhe respektimi i tyre nga ana e Përpunuesit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ndërsa lidhur me kontratën me Mjekun, në nenin 5 të saj përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e Ofruesit të Shërbimit (Mjekut); detyrimi i respektimit të Kodit të Deontologjisë Mjekësore dhe legjislacionit përkatës si dhe detyrimi i konfidencialitetit të të dhënave. Në të përcaktohet edhe vendi ku Mjeku do të ofrojë shërbimin e tij. Për më tepër, përveç kontratës në fjalë, ka rezultuar e provuar se Mjeku ka nënshkruar edhe Dokumentin e përcaktimit si person i autorizuar në trajtimin e të dhënave personale ku janë përcaktuar edhe mënyrat e përpunimit të të dhënave dhe përshkrimin e detyrave të Përpunuesit sikurse Ligji dhe Udhëzimi parashikojnë. Në pikën 9 të këtij Udhëzimi thuhet se: “Për të përmbushur qëllimet e tyre kontrolluesi dhe përpunuesi kanë mundësinë të zgjedhin që të bëjnë një kontratë të veçantë për përcaktimin e rregullave të mbrojtjes së dhënave personale, ose ta vendosin atë si pjesë të kontratës së tyre të*

biznesit, të dyja rastet janë të pranueshme... ". Në rastin konkret palët kanë vendosur të lidhin midis tyre kontratën e shërbimit si dhe të përcaktojnë më në detaje rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale në dokumentin e autorizimit. Pra, sipas fakteve dhe provave të vendosura në dispozicion të grupit të inspektimit shoqëria nuk ka shkelur dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhënien midis kontrolluesit dhe përpunuesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e kontrolluesit nuk qëndrojnë pasi, përmbajtja e neneve që citon kontrolluesi nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19. Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave nga përpunuesit, kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në mënyrë që këta të fundit të garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Gjithashtu, referuar pikës 2 të nenit 20 të ligjit, detyrimet e pikës 1 të këtij neni, duhet të parashikohen në kontratën e shkruar midis kontrolluesit me përpunuesit.

6. *Lidhur me konstatimin e pikës së shtatë të procesverbalit Kontrolluesi argumenton se Inspektorët pretendojnë se kanë verifikuar nga regjistri elektronik mosdeklarimin në rubrikën 1.1 dhe 3.1 të formularit të njoftimit të dhënave të subjektit Kontrollues në kundërshtim me nenet 21 dhe 22 të Ligjit. Për sa i përket këtij pretendimi, nuk rezulton të jetë i vërtetë pasi rezulton e provuar se, me formularin e vënë në dispozicion të inspektorëve edhe me ndryshimet e mëvonshme të tij, por edhe nga një kërkim i drejtpërdrejtë në faqen zyrtare të Komisionerit rezulton se kjo pikë është përmbushur nga ana e BConnect sipas kërkesave ligjore. Ndërsa, për sa i përket pikës 3.1 vizitorët i ka përfshirë në grupet e tjera të deklaruara pa e përcaktuar specifikisht si "Vizitorë". Në asnjë rast nuk mund të konsiderohet shkelje e parashikimeve të ligjit dhe/ose akteve rregulluese vetëm fakti se nuk është specifikuar në formularin e deklaramit fjala "vizitorë".*

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e kontrolluesit nuk qëndrojnë dhe janë të pasakta pasi, konstatimi i grupit të kontrollit nuk ka evidentuar mungesën e kryerjes së njoftimit në vetvete, por mos përditësimin e tij. Sikurse është parashikuar në pikën 1 të nenit 21 të ligjit, kontrolluesi duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, dhe njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënave për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë, sipas nenit 22 të këtij ligji. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave, për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

7. *Lidhur me konstatimet e pikës së tetë të procesverbalit, që konsistojnë në mungesë të rregullores së privatësisë në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit dhe gjithashtu nuk ka marrë masa si përpunues i madh të ngrejë, administrojë dhe mirëmbajë sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit të parashikuar nga Udhëzimi nr. 47 datë 14.09.2018, Kontrolluesi argumenton se dokumentet i janë vendosur në dispozicion edhe Inspektorëve më datë 13 dhjetor 2022. Shoqëria disponon një rregullore të*

brendshme të saj ku në fund janë përshkruar rregullat e privatësisë, të dhëna mbi përpunuesit, mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, qëllimi i përpunimit, kategorinë e subjekteve të përpunimit, përshkrimin e masave të marra nga shoqëria etj. Shoqëria, në mënyrë të vazhdueshme merr masa për përditësimin e kësaj rregulloreje për të qenë konform legjislacionit në fuqi. Ndoshta dita e fundit e inspektimit dhe dokumentet e dorëzuara prej shoqërisë nuk janë mundur të shqyrtohen nga grupi i Inspektimit. Për sa i përket Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, shoqëria me kërkesë të Inspektorëve ka vendosur në dispozicion Politikën e Sigurisë së Informacionit ku përshkruhen mënyra e ndërtimit, zbatimit dhe operimit të këtij sistemi (SMSI) që është në fuqi prej vitit 2018. Qëllimi i shoqërisë është të përditësohet dhe në një të ardhme synon edhe të miratojë këtë sistem në përputhje edhe me kërkesat e standardit ndërkombëtar të ISO/IEC 270001. Pra, nga ana e Subjektit këto dokumente janë vendosur në dispozicion sipas kërkesave të grupit të Inspektimit dhe përmbajnë ato të dhëna që kërkohen nga legjislacioni në fuqi si, vlerësimi dhe trajtimi i riskut, organizimi i sigurisë së informacionit, menaxhimi i asetëve, marrjen e masave të ndryshme për mjetet dhe për punëmarrësit e shoqërisë, sigurinë fizike të pajisjeve kompjuterike etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e kontrolluesit nuk qëndrojnë pasi edhe dokumenti i vendosur në dispozicion (*edhe në seancë dëgjimore*), me titull “*Politika sul sigurezza dell’informazione (PSI)*” është vetëm një nga elementet e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale. Referuar pikës 11 të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale përmban:

- a) *Analizën e Ndikimit në të Dhënat Personale. Përpara përpunimit të të dhënave personale, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të kryejë një vlerësim të ndikimit të operacioneve të përpunimit që janë parashikuar në mbrojtjen e të dhënave personale duke evidentuar se ku këto operacione përpunimi mund të paraqesin rreziqe të veçanta ndaj të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave për shkak të natyrës, shtrirjes ose qëllimit të tyre;*
- b) *Politikën e Sigurisë së Informacionit, përfshirë sigurinë e përpunimit të të dhënave personale;*
- c) *Kontrollin e sigurisë së sistemit të arkivimit të të dhënave personale;*
- ç) *Udhëzime të detajuara të sigurisë që mbulojnë fushat specifike;*
- d) *Sigurinë fizike brenda dhe jashtë ambienteve;*
- dh) *Sigurinë e personelit dhe pajisjeve elektronike të lëvizshme ose jo.*

Ndërsa sa i takon pretendimeve në lidhje me rregulloren, rezulton se Kontrolluesi administron një dokument me emërtimin “*Regolamento aziendale*” megjithatë ky akt nuk përbën “*Rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një

detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze, megjithatë vlerëson angazhimin e Kontrolluesit për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 39 pika 1, gjerat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;

- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, të marrë masa për shkatërrimin e të dhënave të ruajtura/mbledhura në tejkallim të qëllimit të përpunimit për të cilat janë mbledhur;
- 6- Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale për të gjitha proceset përpunuese, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
- 7- Kontrolluesi, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve të nenit 18 të Ligjit;
- 8- Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
- 9- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “*Njoftimit*” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
- 10- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
- 11- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.
- 12- Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - i. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 5 më sipër;
 - ii. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 6, 7 dhe 9 më sipër;
 - iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 8 dhe 10 më sipër;
 - iv. brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 11 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

13- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

14- Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;

15- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 29.12.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi